



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 154

Tiranë – E martë, 16 gusht 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Ligj nr. 77/2016, datë 22.7.2016	Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës ndërmjet shtetit shqiptar dhe kompanisë “Star Bridge Port Developments Limited”, me objekt projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e portit të Karpenit, zonës mbështetëse të portit dhe asaj ekonomike.....	11827
Dekret i Presidentit nr. 9718, datë 8.8.2016	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	11828
Dekret i Presidentit nr. 9720, datë 8.8.2016	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	11828
Urdhër i ministrit të Zhvillimit Urban nr. 58, datë 22.6.2016	Për delegim kompetencash.....	11828
Urdhër i ministrit të Mjedisit nr. 146, datë 4.8.2016	Për delegim kompetencash.....	11829
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 86, datë 3.8.2016	Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarive shtesë nga Banka Amerikane e Investimeve sh.a.....	11829
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 125, datë 29.7.2016	Mbi miratimin e rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave.....	11830
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 126, datë 29.7.2016	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e marrëveshjes së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe furnizuesit..	11835
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 127, datë 29.7.2016	Mbi kërkesën e KESH sh.a. për anulimin e vendimit nr. 103, datë 23.6.2016, “Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.....	11835

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 128, datë 29.7.2016	Mbi tarifat e shitjes me pakicë të energjisë elektrike për klientët e lidhur në TM dhe me matës në TU, për periudhën 1 korrik–31 dhjetor 2016..	11836
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 129, datë 29.7.2016	Mbi ankimin administrativ të OST sh.a. ndaj vendimit të Bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, “Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”	11837
Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 4018, datë 9.8.2016	“Për shpronësimet për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Tiranë–Elbasan” (shtesat), për pasuritë e llojit “kullotë”, “arë”, “drufrutorë” dhe “kultura bujqësore”	11837
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Anri Maliqaj..	11839
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Erion Isufaj.....	11839
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Shaban Kolli.....	11839
	Ndreqje gabimi.....	11839
	Ndreqje gabimi.....	11840



LIGJ
Nr. 77/2016

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË
VEÇANTË PËR NEGOCIMIN DHE
LIDHJEN E KONTRATËS NDËRMJET
SHTETIT SHQIPTAR DHE KOMPANISË
“STAR BRIDGE PORT DEVELOPMENTS
LIMITED”, ME OBJEKT PROJEKTIMIN,
NDËRTIMIN, OPERIMIN,
MIRËMBAJTJEN DHE MENAXHIMIN E
PORTIT TË KARPENIT, ZONËS
MBËSHTETËSE TË PORTIT DHE ASAJ
EKONOMIKE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj përcakton procedurën e veçantë për negociimin dhe lidhjen e kontratës ndërmjet shtetit shqiptar dhe kompanisë “Star Bridge Port Developments Limited”, me objekt projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e portit të Karpenit, zonës mbështetëse të portit dhe asaj ekonomike.

Neni 2
Procedura e negociimit

Procedura e negociimit për lidhjen e kontratës ndiqet nga Komisioni i Negocimit të Kontratës, i kryesuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë, me anëtarë, përfaqësues të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë dhe Avokaturës së Shtetit, i cili fillon negociatat brenda afatit prej 45 ditësh nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Komisioni i Negocimit të Kontratës asistohet nga një konsulent i huaj, i cili bën vlerësimet ligjore dhe financiare të propozimit të paraqitur dhe kontratës që do të lidhet. Përzgjedhja e konsulentit bëhet nga Avokatura e Shtetit, në përputhje me

vendimin nr. 392, datë 8.4.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale””.

Komisioni i Negocimit të Kontratës negocion me kompaninë “Star Bridge Port Developments Limited” propozimin e paraqitur prej tyre dhe përpilon projektkontratën finale, shoqëruar me relacionin përmbyllës të negociatave.

Projektkontrata, e shoqëruar me relacionin përmbyllës të negociatave, brenda një afati prej 60 ditësh nga data e nisjes së negociatave, u dërgohet për nënshkrim Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministrisë të Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministrisë të Energjisë dhe Industrisë.

Neni 3
Nënshkrimi i kontratës

Nënshkrimi i kontratës nga Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministri i Energjisë dhe Industrisë bëhet brenda afatit kohor prej 10 ditësh nga data e marrjes së projektkontratës dhe relacionit përmbyllës të negociatave.

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministri i Energjisë dhe Industrisë mund t’i kërkojnë Komisionit të Negocimit të Kontratës rishikimin e projektkontratës. Ky komision duhet të rinegociojë dhe t’ua paraqesë për nënshkrim ministrave projektkontratën, të shoqëruar me relacionin përmbyllës të negociatave, brenda afatit kohor prej 30 ditësh, duke filluar nga afati i rikthimit.

Neni 4
Miratimi i kontratës

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministri i Energjisë dhe Industrisë dërgojnë për miratim në Këshillin e Ministrave projektligjin e hartuar nga Komisioni i Negocimit të Kontratës, brenda 10 ditëve nga data e nënshkrimit të saj nga të tre ministrat.

Kontrata miratohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.



Data e hyrjes në fuqi të kontratës do të jetë data e hyrjes në fuqi të ligjit, pas miratimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 22.7.2016

DEKRET Nr. 9718, datë 8.8.2016

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Kerim Muslu Erat
2. Raif Hüseyin Türkoğlu
3. Mite Spase Janev
4. Halim Selahattin Karik
5. Selma Yusuf Karik (Şen)
6. Ümit Ismail Avara
7. Rukiye Idris Tiryaki (Yığman)
8. Victoria (Viktorija) Vladimir Kukeli (Asorgina)
9. Adem Reshat Grbolar
10. Roksana Helena Tadeusz Henryk Nowak
11. Afërdita Tahir Hasanaj (Bezhani)
12. Gilbert Hamzi Dema
13. Selvere Selim Myftari (Gashi)
14. Antonio Michele Monticelli
15. Pelin Mustafa Şişman
16. Mimoza Gjergj Gashi
17. Mariya (Marija) Valeriy (Valerij) Makarova
18. Mark Matej Nrecaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET Nr. 9720, datë 8.8.2016

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Visar Musli Ymeri
2. Dardan Brahim Molliqaj
3. Aida Ali Dërguti
4. Albin Zaim Kurti
5. Glaus Sherif Konjufca
6. Liburn Ali ALiu
7. Shkumbin Uran Qormemeti

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

URDHËR Nr. 58, datë 22.6.2016

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje të neneve 28, 29 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, kreut II, “Organizimi dhe funksionimi i agjencisë”, të VKM-së nr. 725, datë 2.9.2015, “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit” dhe urdhrit të Kryeministrit nr. 91, datë 24.5.2016, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”,



URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, Drejtorit të Drejtorisë Juridike znj. Alisa Ramollari.

2. Këto kompetenca do të ushtrohen për periudhën 10.7.2016 deri më 17.7.2016.

3. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet znj. Alisa Ramollari.

4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I
AGJENCISË SË ZHVILLIMIT
TË TERRITORIT
Ledia Tota

URDHËR

Nr. 146, datë 4.8.2016

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të shkronjës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave administrative që zotëron Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Drejtorit të Përgjithshëm të Mjedisit dhe Jetësisit të Prioriteteve z. Pëllumb Abeshi, për periudhën nga data 5.8.2016 deri në datën 10.8.2016.

2. Delegimin e kompetencave administrative që zotëron Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimeve Mbështetëse znj. Valbona Ballgjini për periudhën nga data 11.8.2016 deri në datën 22.8.2016.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtori i Përgjithshëm i Mjedisit dhe Jetësisit të Prioriteteve z. Pëllumb Abeshi dhe Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse znj. Valbona Ballgjini.

4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT
Lefter Koka

VENDIM

Nr. 86, datë 3.8.2016

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT
PARAPRAK PËR KRYERJEN E
VEPRIMTARIVE SHITESË NGA BANKA
AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, nenit 43, shkronjat “c” dhe “e”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 23, pikat 1 dhe 3, nenit 24, pika 1, shkronja “ç” dhe të nenit 54, pika 2, shkronja “b”, shkronja “dh”, nënpika “v”, shkronja “e”, nënpikat “i” dhe “ii” dhe shkronja “ë” të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 14, datë 11.3.2009, e ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraparak për kryerjen nga Banka Amerikane e Investimeve sh.a. të veprimtarive financiare shtesë, si më poshtë:

a) *Factoring*-un dhe financimin e transaksioneve tregtare;

b) Tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetorganizuar (OTC) ose ndryshe, të letrave me vlerë të transferueshme.

c) Ndërmjetësimin për transaksionet monetare të mëposhtme:

i) Administrimin e aktiveve, të tilla si: administrimi i parave dhe i portofolit, administrimi i fondeve, marrja në kujdestari, shërbimet depozi-tuese dhe të besimit;

ii) Shërbimin për kompensimin dhe shlyerjen e pagesave të aktiveve financiare, duke përfshirë letrat me vlerë, produktet derivative dhe instrumente të tjera të negociueshme;

d) Shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e listuara më sipër, duke përfshirë referencën e kredisë dhe të analizës, kërkimin dhe këshillimin në lidhje me investimet dhe portofolin, si dhe këshillimin mbi blerjet e mbi strategjinë dhe ristrukturimin e shoqërive.



2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të kryer ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Bankës Amerikane të Investimeve sh.a., sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gent Sejko

VENDIM
Nr. 125, datë 29.7.2016

**MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR
PROCEDURAT E VENDOSJES DHE
REDUKTIMIT TË GJOBAVE**

Në mbështetje të neneve 16; 106/2; 107, pika 4 dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 26, të “Rregulloreve të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.7.2016, pasi shqyrtoi draftrregulloren për procedurat e vendosjes dhe të reduktimit të gjobave, të përgatitur nga Drejtoria Juridike, si dhe relacionin përkatës,

konstatoi se:

- Në bazë të nenit 107, pika 4, ERE ka detyrimin të hartojë dhe të miratojë një rregullore të posaçme lidhur me kushtet dhe procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave.

- Me vendimin nr. 152, datë 11.12.2015, Bordi i ERE-s ka filluar procedurat për miratimin e “Draftrregulloreve për vendosjen e gjobave dhe kushtet e lehtësimit prej tyre”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

RREGULLORE
PËR PROCEDURAT E VENDOSJES DHE
REDUKTIMIT TË GJOBAVE

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Autoriteti

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 106/2 dhe 107, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ligjit nr. 45/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe në përputhje me “Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të sigurojë një trajtim të barabartë e transparent për të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, për të cilët ERE nis procedurën për vendosjen e gjobave për shkeljet e konstatuara, sipas parashikimeve të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

ERE aplikon procedura të njëjta për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike në rastet e vendosjes së gjobave.

Neni 3
Objekti

Kjo rregullore përcakton procedurat e aplikimit të gjobave, metodologjinë e konstatimit e përcaktimit të tyre, si dhe masat e lehtësimit që aplikohen për gjobat e vendosura, për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, në rastet e shkeljeve të ndëshkueshme me gjobë nga ERE.

Neni 4
Përkufizime

Fjalët dhe frazat e mëposhtme të përdorura në këtë rregullore, kur përdoren, do të kenë kuptimet e mëposhtme:



1. “Ligj” do të thotë ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

2. “Bordi i ERE-s” do të thotë organi vendimmarrës i ERE-s që përbëhet nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara në ligj.

3. “ERE” do të thotë Enti Rregullator i Energjisë.

4. “Licencë” do të thotë një e drejtë e dhënë nga ERE, një personi për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e energjisë elektrike ose atë të gazit natyror, në përputhje me dispozitat që kërkohen nga ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjit nr. 102/2015, “Për gazin natyror”, si dhe procedurave të licencimit të ERE-s.

5. “I licencuar” do të thotë një person i pajisur me një licencë të dhënë nga ERE, për të operuar në sektorin e energjisë elektrike ose dhe të gazit natyror.

6. “Procedurë” do të thotë një tërësi e veprimeve të ERE-s apo të të licencuarve që kryhen në zbatim të legjislacionit në fuqi.

7. “Administratori” do të thotë sipas rastit Kryetari i Bordit të ERE-s ose Bordi i ERE-s.

8. “Subjekt i interesuar” do të thotë çdo i licencuar apo çdo person tjetër që merr shërbim apo kryen aktivitet në sektorin e energjisë elektrike.

9. “Të ardhurat vjetore” do të thotë totali i të ardhurave të gjeneruara nga shitja e të mirave të siguruara nga aktiviteti në sektorin e energjisë elektrike apo shërbimeve të kryera gjatë një viti financiar nga një subjekt tregtar.

10. “Xhiro mesatare ditore” do të thotë të ardhurat mesatare të siguruara në ditë nga shitjet përgjatë një viti financiar.

11. “Vlera fillestare e gjobës” do të quhet vlera e përcaktuar nga Bordi i ERE-s, për efekt të llogaritjes së vlerës përfundimtare të gjobës e cila llogaritet sipas aneksit nr. 1 bashkëngjitur kësaj rregulloreje.

PJESA E DYTË DISPOZITA TË POSAÇME

Neni 5 Gjobat

1. Çdo i licencuar mund të jetë subjekt i ndëshkimit nga ERE, për një ose më shumë nga shkeljet e kryera prej tij, si më poshtë:

a) Moszbatim i vendimeve të ERE-s;

b) Refuzimi i paraqitjes së të dhënave dhe raporteve periodike apo dërgimi me vonesë i tyre ose dërgimi i të dhënave jo të plota dhe të pasakta nga i licencuari. Dërgimi i qëllimshëm i të dhënave të rreme përbën veprë penale, e ndëshkohet konform parashikimeve të Kodit Penal;

c) Moszbatimi i detyrimeve që lidhen me llogaritjen e kostove dhe tarifave, si dhe zbatimin e tyre;

d) Moszbatimi i detyrimeve të shërbimit publik, të parashikuara në nenin 47, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”;

e) Moszbatim i detyrimeve për ndarjen e veprimtarive të licencuara;

f) Moszbatimi i detyrimit për mbetjen e llogarive të ndara, sipas neneve 35, 54 dhe 72 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”;

g) Moszbatimi i detyrimeve që lidhen me aksesin e palëve të treta në rrjet, siç përcaktohet nga dispozitat e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe aktet e tjera nënligjore;

h) Moszbatimi i detyrimeve të përcaktuara në kontratat e rregulluara;

i) Mospublikimi informacionit për tarifatat dhe kushtet e përgjithshme të aksesit dhe të përdorimit të shërbimeve të rrjetit;

j) Mosparaqitja e programeve të investimeve dhe/ose moskryerja e investimeve të planifikuara, sipas kërkesave të neneve 20, shkronja “P”, 60 dhe 75, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe rregullores përkatëse të ERE-s;

k) Shkelja e një prej kushteve e kërkesave të cilësisë së furnizimit, të miratuara nga ERE;

l) Moszbatim i vendimeve të ERE-s, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve;

m) moskryerja e pagesës rregullore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar;

n) refuzimi i pjesëmarrësve të tregut për të nënshkruar kontrata të rregulluara brenda 15 ditëve kalendarike;

o) Shkeljet e kushteve të përcaktuara në licencë apo shkeljet e rregullave dhe rregulloreve të ERE-s, që nuk janë përcaktuar në shkronjat e mësipërme.

2. ERE mund të vendosë gjobë progresive për çdo ditë vonesë në korigjimin e shkeljes, duke filluar ky afat nga dita e afatit të përcaktuar nga ERE për korigjimin e saj apo nga legjislacioni në fuqi:



a) Kur i licencuari nuk përmbush vendimin e ERE-s për korrigjimin e një shkeljeje brenda afateve të përcaktuara prej saj, i licencuari dënohet me gjobë në masën 0,1 për qind të xhiros mesatare ditore të vitit financiar paraardhës, për çdo ditë vonese nga dita e afatit të përcaktuar në vendimin përkatës të ERE-s;

b) Kur i licencuari nuk përmbush detyrimin e pagesës rregullatore ndaj ERE-s, dënohet me gjobë në masën 0,2 për qind të xhiros mesatare ditore të vitit financiar paraardhës, për çdo ditë vonese nga dita e përcaktuar për pagesën.

3. Masat e gjobës do të përcaktohen nga ERE, në përputhje me aneksin 1 të kësaj rregulloreje, brenda kufijve si më poshtë:

a) Jo më shumë se 3% e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit;

b) Jo më pak se 0,1% e të ardhurave vjetore të vitit financiar paraardhës të të licencuarit.

4. Gjoha progresive për çdo ditë vonese, nuk mund të kalojë vetë vlerën e gjobës fillestare ose masën e 3% të të ardhurave të vitit paraardhës.

5. Vlera përfundimtare e gjobës do të përcaktohet si zbritje e vlerës fillestare të gjobës me vlerën e kushteve lehtësuese, nëse kjo e fundit mund të aplikohet.

Neni 6

Fillimi i hetimit

1. ERE mund të fillojë një hetim për vendosje gjobe, në rastet kur:

a) Ka marrë kryesisht dijeni për një shkelje;

b) Vihet në dijeni nga një i licencuar tjetër apo nga një subjekt i interesuar për një shkelje;

c) Ka dyshimin e arsyeshem se kushtet e licencës janë shkelur.

2. Në çdo rast fillimi i hetimit vendoset me urdher të administratorit apo vendim të Bordit të ERE-s.

Neni 7

Shqyrtimi fillestar

1. ERE nuk mund të vendosë për fillimin e një procedure për vendosje gjobe, nëse shkelja e pretenduar apo e konstatuar pas hetimit rezulton se ka më shumë se 5 vjet që ka ndodhur.

2. Në çdo rast që stafi teknik, i cili ka kryer hetimin, konstaton një nga shkeljet e parashikuara në nenin 5, do të përgatisë një informacion/ relacion të detajuar mbi shkeljen/et e konstatuara

dhe propozimin për fillimin e procedurës, për vendosje gjobe ndaj të licencuarit.

3. Vendimi i Bordit të ERE-s për të filluar procedurën e vendosjes së gjobës një të licencuari, do t'i njoftohet të licencuarit nga ERE, brenda 5 ditëve pune nga marrja e vendimit të Bordit të ERE-s.

4. Njoftimi për vendosjen e gjobës do të përmbajë:

- shkeljen e konstatuar;

- masën e gjobës së propozuar;

- identitetin e të licencuarit;

- dokumentacionin provues ku mbështetet vendosja e gjobës;

- të drejtën e të licencuarit për të kthyer përgjigje brenda 10 ditëve kalendarike nga marrja në dijeni, si dhe paraqitjen e argumenteve dhe çdo dokumentacioni shkresor mbështetës në funksion të përgjigjes së tyre apo për qëllime të aplikimit të rrethanave lehtësuese. I licencuari ka të drejtë që brenda këtij afati, të kërkojë zhvillimin e një seance dëgjimore për të bërë sqarimet e duhura.

5. Në çdo fazë të një procedimi për vendosje gjobe, ERE mund të kryejë seanca dëgjimore me të licencuarin dhe subjektin që ka kërkuar kryerjen e hetimit apo ERE mund të kërkojë dokumente të tjera të nevojshme për qëllime të procedurës së nisur.

Neni 8

Përcaktimi i vlerës fillestare të gjobës

1. ERE do të përcaktojë vlerën fillestare të gjobës brenda kufirit maksimal dhe minimal të vendosur në ligj. Rëndësia e shkeljes do të përcaktohet sipas kriterëve të mëposhtme:

a) Rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes;

b) Nëse kundërvajtësi rezulton i dënuar administrativisht më parë;

c) Rëndësinë e kundërvajtjes;

d) Pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi;

e) Nëse kundërvajtësi është dënuar më parë për të njëjtën kundërvajtje.

Neni 9

Rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes

1. Për efekt të llogaritjes së vlerës fillestare të gjobës rrethanat e kryerjes së shkeljes do të konsiderohen të lehta, mesatare apo të rënda.



2. Për përcaktimin e niveleve të rrethanave do të merren për bazë kriteret e mëposhtme:

- a) Pozicioni hierarkik në kompani i personit që ka kryer shkeljen;
- b) Mungesa e modeleve organizative dhe të rregullave të menaxhimit korrekt, me qëllim parandalimin e kryerjes së shkeljes;
- c) Përpjekjet për të fshehur shkeljen.

Neni 10

Subjekti me precedentë dënimi administrativ

Nëse i licencuari është dënuar më parë për shkelje të legjislacionit të sektorit të energjisë, është dënuar më parë për të njëjtën kundërvajtje administrative, gjoba përfundimtare e parashikuar për llojin e kundërvajtjes, do të rritet në masën 10% të vlerës së gjobës minimale të kriterit përkatës të parashikuar në aneksin 1.

Neni 11

Rëndësia e shkeljes së kryer

1. Për efekt të llogaritjes së rëndësisë së shkeljes së kryer, ato do të konsiderohen të rëndësisë së ulët, mesatare apo të lartë.

2. Për përcaktimin e nivelit të rëndësisë së shkeljes së kryer do të merret për bazë:

- a) Përfitimi financiar i realizuar nga i licencuari, i cili do të llogaritet mbi bazën e raportit të të ardhurave të përfituara me të ardhurat vjetore të vitit paraardhës të të licencuarit;
- b) Dëmi i shkaktuar në palë të treta.

Neni 12

Pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi

1. Për efekt të llogaritjes së vlerës fillestare të gjobës, pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi i të licencuarit do të konsiderohen të nivelit të ulët, mesatar apo të lartë.

2. Për përcaktimin e niveleve të pasojave do të merren për bazë kriteret e mëposhtme:

- a) Dëmi i shkaktuar apo rritja e kostove të shkaktuara konsumatorëve apo pjesëmarrësve në treg;
- b) Numri i klientëve të përfshirë;
- c) Rritja e dominancës në treg të të licencuarit;
- d) Pengimi i punës së rregullatorit në kryerjen e funksioneve të veta ligjore për monitorimin dhe kontrollimin e të licencuarit.

Neni 13

Lehtësimi nga gjoba

1. ERE do të konsiderojë se i licencuari plotëson kushtet për lehtësimin në vlerën e gjobës, kur gjatë hetimit rezulton se ekzistojnë një ose të gjitha rrethanat, si më poshtë:

a) Në masën 50 për qind, në rastet kur shkelja, për të cilën parashikohet gjoba, është njoftuar nga vetë i licencuari;

b) Në masën 1/3, në rastet kur i licencuari bashkëpunon në mënyrë aktive në procesin e hetimit administrativ të ERE-s, për konstatimin e shkeljes në fjalë;

c) Në masën 40 për qind, në rastet kur i licencuari provon se ka ndërmarrë veprime konkrete për përmirësimin apo zhdukjen e pasojave që ka shkaktuar shkelja, përpara ose gjatë konstatimit të shkeljes nga ERE.

d) Do të konsiderohen veprime që çojnë në përmirësimin e tregut, veprimet të cilat pavarësisht shkeljes kanë ndikuar në përmirësimin e standardeve të shërbimit, konkurrencës, eficiencën në treg etj.

Neni 14

Propozimi përfundimtar

1. Pas marrjes së përgjigjes me shkrim nga i licencuari, brenda afatit të përcaktuar më sipër, personat e ngarkuar që ndjekin këtë procedurë në ERE, do të shqyrtojnë këtë përgjigje brenda afatit të vendosur nga Bordi i ERE-s dhe do të përgatisin një relacion për Bordin mbi argumentet e paraqitura në përgjigjen e të licencuarit, rrethanat lehtësuese dhe gjithë dokumentacionin mbështetës, nëse ka dhe do t'i propozojnë Bordit të ERE-s përmbylljen e procedurës së nisur për vendosjen e gjobës, vlerën fillestare të gjobës dhe nëse ekzistojnë kushtet për uljen e vlerës së gjobës së propozuar apo mosgjybitjen e të licencuarit për moskonstatim të shkeljes.

2. Bordi i ERE-s mund të vendosë të mosgjybisë të licencuarin, sipas propozimit të stafit teknik nëse konstaton se faktet e paraqitura nuk provojnë shkeljen.

Neni 15

Vendimi i Bordit

1. Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas dispozitave të mësipërme të kësaj



rregulloreje dhe pasi është njohur me përgjigjen e të licencuarit, Bordi i ERE-s do të vendosë për ndëshkimin ose jo të të licencuarit dhe vlerën përkatëse të gjobës.

2. Në përfundim të një procedure për vendosjen e gjobës një subjekti të licencuar, ERE do të njoftojë të licencuarin mbi përfundimin e procedurës së nisur ndaj tij, si dhe do t'i dërgojë një kopje të vendimit të Bordit, brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja e vendimit.

3. Gjoha e vendosur nga Bordi i ERE-s përbën titull ekzekutiv dhe do të ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.

Neni 16

Apelimi i vendimit

Kundër vendimit të Bordit të Komisionerëve për vendosje të gjobës, i licencuari mund të bëjë ankim në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

PJESA E TRETË DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 17

Amendamente të rregullores

Këto rregulla janë objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të ERE-s, në përputhje me “Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore dhe pjesët përbërëse të saj, hyjnë në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

ANEKSI 1

TABELA PËR LLOGARITJEN E VLERËS PËRFUNDIMTARE TË GJOBËS

Faza I: Fiksimi i vlerës fillestare të gjobës, në varësi të rëndësisë së shkeljes			
Kriteret e rëndësisë së shkeljes			
1. Kohëzgjatja e shkeljes dhe shtrirja territoriale e saj	25 %	E shkurtër	2 %
		E mesme	6%
		E gjatë	12 %
		Lokale	2 %
		Rajonale	4 %
		Kombëtare	13%
2. Ndikimi i shkeljes në funksionimin e tregut të energjisë	25 %	I ulët	2 %
		I mesëm	6 %
		I lartë	13 %
3. Përfitimi ekonomik i realizuar nga i licencuari si pasojë e shkeljes	25 %	I ultë	4 %
		Mesatar	8 %
		I lartë	12 %
4. Lloji i fajësisë së të licencuarit	25 %	Dashje	17 %
		Pakujdesia	8 %
Faza II: Llogaritja e gjobës përfundimtare do të bëhet sipas formulës: Gj= VFGj-KL ku: Gj = Gjoha VFGJ = Vlera fillestare KL = Kushtet lehtësuese			
Kushtet lehtësuese	1. Shkelja për të cilën parashikohet gjobë deklarohet nga vetë i licencuari		50%
	2. I licencuari bashkëpunon në mënyrë efikase në procesin e investigimit të rregullatorit për shkeljen në fjalë		33%
	3. I licencuari demonstroi se ka bërë veprime që çojnë në përmirësimin e tregut të rregulluar		40%

**VENDIM**

Nr. 126, datë 29.7.2016

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET
OST SHA DHE FURNIZUESIT**

Në mbështetje të nenit 16, të seksionit IV, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij, të datës 29.7.2016, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s, për miratimin e marrëveshjes së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe furnizuesit,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e marrëveshjes së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike ndërmjet OST sh.a. dhe furnizuesit.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Petrit Ahmeti**

VENDIM

Nr. 127, datë 29.7.2016

**MBI KËRKESËN E KESH SHA PËR
ANULIMIN E VENDIMIT NR. 103, DATË
23.6.2016, “MBI MIRATIMIN E
RREGULLORES PËR PROCEDURAT E
BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE
PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË
RRJETET E SHPËRNDARJES DHE TË
TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN
DHE SHITJEN E ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR
PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË
SHËRBIMIT PUBLIK”**

Në mbështetje të nenit 16, pikat 1 dhe 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 16, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.7.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike mbi kërkesën e KESH sh.a. për anulimin e vendimit nr. 103, datë 23.6.2016, “Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”,

konstatoi se:

- Shoqëria KESH sh.a., me anë të shkresës nr. 5703 /1 prot., datë 12.7.2016, i është drejtuar ERE-s, me një ankim administrativ mbi vendimin nr. 103, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s, “Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.

- Ky vendim i është komunikuar shoqërisë KESH sh.a. nëpërmjet shkresës nr. 496 prot., datë 29.6.2016 të ERE-s.

- Mbështetur në nenin 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe nenin 16 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016 të Bordit të ERE-s: Për një vendim të Bordit, çdo palë e



përfshirë në një procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve pune nga data e marrjes dijeni të vendimit.

- Kërkesa e KESH sh.a. për anulimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, është depozituar në ERE jashtë afateve ligjore.

- Nuk është paraqitur asnjë provë e re që të çojë Bordin e ERE-s në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga vendimi nr. 103, datë 23.6.2016 i Bordit të ERE-s.

- Vendimi nr. 103, datë 23.6.2016 i Bordit të ERE-s reflekton parashikimet e ligjit 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe legjislationit në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë KESH sh.a. për anulimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, mbi miratimin e "Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik".

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 128, datë 29.7.2016

MBI TARIFAT E SHITJES ME PAKICË TË ENERGIJË ELEKTRIKE PËR KLIENËTË E LIDHUR NË TM DHE ME MATËS NË TU, PËR PERIUdhËN 1 KORRIK–31 DHJETOR 2016

Në mbështetje të neneve, 16; 20, germa "c" dhe 109, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", VKM-së nr. 244, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike",

vendimit nr. 112, datë 8.7.2016, "Për përcaktimin e të licencuarit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e kushteve për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal" dhe nenit 22 të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.7.2016, pasi shqyrtoi, relacionin e drejtorive teknike,

konstatoi se:

- OSHEE sh.a., me shkresën nr. 10657 prot., datë 20.5.2016, aplikoi për tarifa për një kategori të re konsumatorësh, e cila nuk ka qenë e përfshirë në strukturën ekzistuese të tarifave, konkretisht për konsumatorët e lidhur në TM, por me matje në TU.

- OSHEE deklaroi se një pjesë e klientëve kanë kontrata të pikëlidhjes në TM, por matës të energjisë, në pjesën pas pajisjeve transformuese dhe transmetuese, të cilat janë në pronësi të tyre.

- ERE, me shkresën nr. 508 prot., datë 14.7.2015, ka adresuar tek OSHEE sh.a. zgjidhjen për këtë problematikë, duke kërkuar që në lidhje me grupin e konsumatorëve për të cilët nuk ka mundësi të zhvendoset pika e matjes (për shkak se janë të lidhur në kabina nga të cilat furnizohen edhe klientët të tjerë, kanë konsum të ulët dhe nuk plotësojnë kushtet teknike), të vazhdohet faturimi me çmimin e TU-së.

- Niveli i humbjeve teknike për vitin 2016 parashikohet të jetë më i ulët se viti paraardhës.

- Në zbatim të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe të furnizimit me energji elektrike", OSHEE ka detyrimin të blejë energji nga burimet e rinovueshme të energjisë për mbulimin e humbjeve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Për klientët e lidhur në TM dhe me matës në TU, të miratojë tarifën 12.4 lekë/kwh për shitjen me pakicë të energjisë aktive (jo pik) për periudhën 1 korrik–31 dhjetor 2016 nga furnizuesi universal.



2. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë shoqërinë OSHEE sh.a. për vendim-marrjen e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 129, datë 29.7.2016

**MBI ANKIMIN ADMINISTRATIV TË OST
SHA NDAJ VENDIMIT TË BORDIT TË
ERE-s NR. 103, DATË 23.6.2016, “MBI
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR
PROCEDURAT E BLERJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR
MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETET
E SHPËRNDARJES DHE TË
TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN
DHE SHITJEN E ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR
PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË
SHËRBIMIT PUBLIK”**

Në mbështetje të nenit 16, pikat 1 dhe 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 16, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.7.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike mbi kërkesën e OST sh.a., për anulimin e vendimit nr. 103, datë 23.6.2016, “Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”,

konstatoi se:

- Shoqëria OST sh.a., me anë të shkresës nr. 4207 prot., datë 17.7.2016, i është drejtuar ERE-s, me një ankim administrativ mbi vendimin nr. 103, datë 23.6.2016 të Bordit të ERE-s.

- Vendimi 103, datë 23.6.2016 i është komunikuar shoqërisë OST sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 496 prot., datë 29.6.2016 të ERE-s.

- Mbështetur në nenin 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe

nenin 16, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016 të Bordit të ERE-s: Për një vendim të Bordit, çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve pune nga data e marrjes dijeni të vendimit.

- Kërkesa e OST sh.a. për anulimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016 është depozituar në ERE jashtë afateve ligjore.

- OST sh.a. konstaton vështirësi për implementimin e platformës *IT- Online*.

- Bordi i ERE-s, në pikën 2, të vendimit nr. 103, datë 23.6.2016, ka parashikuar se “rregullorja” hyn në fuqi, jo më vonë se 4 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

- Nuk është paraqitur asnjë provë e re që të çojë Bordin e ERE-s në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga vendimi nr. 103, datë 23.6.2016, i Bordit të ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a. për rishikimin dhe pezullimin e vendimit nr. 103, datë 23.6.2016, “Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumentit të njoftojë shoqërinë OST sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

KËRKESË
Nr. 4018, datë 9.8.2016

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën “Për shpronësimet për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Tiranë–Elbasan” (shesat), për pasuritë e llojit “kullotë”, “arë”, “drufrutorë” dhe “kultura bujqësore”.



Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni, konsiston në masën e vlerësimit të llogarit, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe për llogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit “kullotë”, “arë”, “drufrutorë” dhe “kultura bujqësore”. Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”.

Vlera totale e shpronësimit është 20 269 504 (njëzet milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e katër) lekë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
Thimjo Plaku

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR "TIRANË - ELBASAN (SHITESAT)"

Nr.	PRONARI	ZK	NR. PAS.	LLOJI I PASURISË	SIP. TOTALE	VLERËSIMET			Kultura bujqësore e drufrutorë	VLERA TOTALE (LEKË)	Shënime
	Emri i pronarit					SIP (M2)	CMIMI (LEK/M2)	Vlera(lekë)			
1	Zyhdi Idriz Shaba	2704	538/23	Ullishte	3000	597	523	312231		312231	Konfirmim ZVRPP
2	Bp. Zekthi etj	2735	300/2	Kullotë	470	470	117	54990		54990	Çertifikatë pronësie
3	Bashkepronaret Karamuca	2735	22/5	Arë	4900	390	399	155610		155610	Konfirmim ZVRPP
4	Altin Islam Sula	2735	22/14	Arë	8600	248	399	98952		98952	Konfirmim ZVRPP
5	Bashkim Ramiz Karamuca	2735	22/6/8	Arë	7000	3358	399	1339842		1339842	Konfirmim ZVRPP
6	Vjollca Dilaver Metani	2735	113/18	Arë	3750	1742	399	695058		695058	Konfirmim ZVRPP
7	B. Pronaret Metani	2735	113/9	Arë	5000	2442	399	974358		974358	Konfirmim ZVRPP
8	Zamir Rexhep Metani	2735	127/3	Arë	2000	1301	399	519099		519099	Konfirmim ZVRPP
9	Bashkepronaret Metani	2735	113/11	Arë	2000	747	399	298053		298053	Konfirmim ZVRPP
10	Syrja Dervishi	2735	127/5	Arë	7700	815	399	325185		325185	Konfirmim ZVRPP
11	Myslym Kerciku	1622	23/27	Arë	1800	114	448	51072		51072	Konfirmim ZVRPP
12	Bashkepronaret Kerciku	1622	23/46	Arë	290	64	448	28672		28672	Çertifikatë pronësie
13	Gezim Shefqet Sallaku	1498	426/20/1	Arë	2430	2035			335544	335544	Çertifikatë pronësie
14	Bashkepronaret Sallaku	1498	426/63	Arë	900	900			109650	109650	Çertifikatë pronësie
15	Bashkepronaret Ahmetaj	1170	122/2	Arë	1000	1000			163242	163242	Çertifikatë pronësie
16	Albert Ndue Skana	1977	44/72	Pemtore	7900	7900	470	3713000		3713000	Konfirmim ZVRPP
17	Rexhep Gjuzi	1977	41/5	Pemtore	22700	7663	470	3601610		3601610	Konfirmim ZVRPP
18	Sinan Sherifi	1977	44/69	Pemtore	1500	1500	470	705000		705000	Konfirmim ZVRPP
19	Bashkepronaret Sherifi	1977	44/67	Pemtore	1200	1200	470	564000		564000	Konfirmim ZVRPP
20	Laert Duro & Shansi Invest Shpk	1977	44/58	Pemtore	14000	10500	470	4935000		4935000	Konfirmim ZVRPP
21	Laert Duro & Shansi Invest Shpk	1977	44/39	Arë	6000	1738	470	816860		816860	Konfirmim ZVRPP
22	Besim Çoku	1977	301/11	Arë	3100	262	470	123140		123140	Çertifikatë pronësie
23	Fatmir Ibrahim Velija	2752	22/1	Ullishte	650	650			304536	304536	Çertifikatë pronësie
24	Shtet	2752	57/2	Pemtore	100	100	448	44800		44800	Çertifikatë pronësie
	TOTALI					47736		19356532	912972	20269504	

**VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin numër 5235, datë 18.7.2016, vendosi shpalljen të zhdukur, në datën 1 tetor 2012, të shtetasit Anri Maliqaj, i biri i Dalanit dhe i Lumturisë, i datëlindjes 20.2.1982, si dhe caktimin si kujdestare të pasurisë së tij, bashkëshorten e tij, shtetasen Migena Maliqaj.

KËRKESË

Shtetasi Fiqiri Isufaj kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen të vdekur të shtetasit Erion Isufaj, i biri i Fiqirit dhe i Shpresës, i datëlindjes 21.7.1977, lindur në Tiranë, i cili ka humbur jetën në një aksident automobilistik në Kroaci, në datën 31.7.2014.

KËRKUES
Fiqiri Isufaj

KËRKESË

Shtetasja Afërdita Kolli kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë shpalljen të vdekur të shtetasit Shaban Kolli.

KËRKUES
Afërdita Kolli

NDREQJE GABIMI

Në “Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 127, datë 12.7.2016:

- Neni 2 “Qëllimi i rregullores”

Ishte: *“Qëllimi i kësaj rregulloreje është të sigurojë procedura transparente në ushtrimin e funksioneve të ERE-s, duke garantuar një trajtim të barabartë në dhënien e licencave, kualifikimeve dhe certifikimeve në sektorin e energjisë elektrike, vendosjen e tarifave dhe çmimeve të të licencuarve në aktivitetet e rregulluara, zgjidhjes së konflikteve midis të licencuarve dhe midis të licencuarve dhe klientëve, hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”,*

Bëhet: *“Qëllimi i kësaj rregulloreje është të sigurojë procedura transparente në ushtrimin e funksioneve të ERE-s, duke garantuar një trajtim të barabartë në dhënien e*

licencave dhe certifikimeve në sektorin e energjisë elektrike, vendosjen e tarifave dhe çmimeve të të licencuarve në aktivitetet e rregulluara, zgjidhjes së konflikteve midis të licencuarve dhe midis të licencuarve dhe klientëve, hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

- Neni 3 “Zbatimi”, pika 1, germa “b”:

Ishte: *“trajtimin e aplikimeve për dhënie licence, kualifikim dhe certifikim në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror,”*

Bëhet: *“trajtimin e aplikimeve për dhënie licence dhe certifikim në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror,”*

- Neni 16 “Ridëgjimi dhe ankimi kundër vendimit të Bordit”, pika 1:

Ishte: *“Për një vendim të Bordit, çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve pune nga data e marrjes dijëni të vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.”*

Bëhet: *“Për një vendim të Bordit, çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijëni të vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara”.*

- Neni 18 “Regjistrimi i aplikimit apo kërkesës”, pika 1:

Ishte: *“Punonjësi i protokollit hap një dosje për çdo procedurë, për të cilën këto rregulla janë të aplikueshme, përfshirë ankesat, kërkesat, procedurat e tarifave, çmimeve, licencave, kualifikimeve, certifikimeve dhe relacionet argumentuese në lidhje me një amendament, shtojcë, përfundim, rinovim, heqje të licencës etj. Çdo procedim do të ketë një numër të caktuar në regjistrin e protokollit dhe do t’i bashkëlidhet kartelës shoqëruese, siç përcaktohet në “Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të ERE-s”. Për dokumente të të njëjtit procedim krijohet dosja përkatëse nga zyra e protokollit në bashkëpunim me drejtoritë e ngarkuara për trajtimin e kërkesës apo aplikimit. Punonjësi i protokollit mban një listë për të gjitha procedurat e futura në dosje dhe siguron një kopje të kësaj liste falas për të gjitha palët, përfshirë personat e interesuar që e kërkojnë atë.*

Bëhet: *“Punonjësi i protokollit hap një dosje për çdo procedurë, për të cilën këto rregulla janë të aplikueshme,*



përfshirë ankesat, kërkesat, procedurat e tarifave, çmimeve, licencave, certifikimeve dhe relacionet argumentuese në lidhje me një amendament, shtojcë, përfundim, rinovim, heqje të licencës etj. Çdo procedim do të ketë një numër të caktuar në regjistrin e protokollit dhe do t'i bashkëlidhet kartelës shoqëruese, siç përcaktohet në “Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të ERE-s”. Për dokumente të të njëjtit procedim krijohet dosja përkatëse nga zyra e protokollit në bashkëpunim me drejtorinë e ngarkuara për trajtimin e kërkesës apo aplikimit. Punonjësi i protokollit mban një listë për të gjitha procedurat e futura në dosje dhe siguron një kopje të kësaj liste falas për të gjitha palët, përfshirë personat e interesuar që e kërkojnë atë.”

- Neni 19 “Fillimi i procedurës”, pika 1, germa “d”:

Ishte: “Kualifikim dhe dhënie të certifikatës së origjinës së prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme të energjisë.”

Bëhet: “dhënie të certifikatës së origjinës së prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme të energjisë.”

NDREQJE GABIMI

Në vendimin e ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016, “Mbi miratimin e licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 127, datë 12.7.2016:

Në faqen e parë të licencës:

Ishte: “Kodi Fiskal”

Bëhet: “NUIS”.

Po aty, paragrafi i fundit:

Ishte: “Bazuar në autoritetin që i është dhënë në pjesën e pestë të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) i jep këtë licencë prodhimi (Licenca), për të kryer aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike (PEE), personit të lartpërmendur, i quajtur “I licencuari”, subjekt i kushteve të kësaj licence, si dhe kushteve të përcaktuara në vendimin e Bordit të ERE-s. Kjo licencë hyn në fuqi në datën e shëruar

më lart dhe do të vazhdojë të jetë në fuqi për një periudhë prej ___, në rast se nuk përfundohet ose pezullohet nga ERE, në përputhje me kushtet e licencës të përfshira këtu.”

Bëhet: “Bazuar në autoritetin që i është dhënë në pjesën e pestë të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) i jep këtë licencë tregtimi (Licenca), për të kryer aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (PEE), personit të lartpërmendur, i quajtur “I licencuari”, subjekt i kushteve të kësaj licence, si dhe kushteve të përcaktuara në vendimin e Bordit të ERE-s. Kjo licencë hyn në fuqi në datën e shëruar më lart dhe do të vazhdojë të jetë në fuqi për një periudhë prej ___, në rast se nuk përfundohet ose pezullohet nga ERE, në përputhje me kushtet e licencës të përfshira këtu.”

Pika 3.6.4:

Ishte: “I licencuari do ta njoftojë ERE-n brenda 10 ditëve, për çdo ndryshim të:

- a) Adresës;
- b) Statutit të të licencuarit;
- c) Certifikatës së regjistrimit;
- d) Kodit Fiskal;
- e) Drejtuesve të lartë; ose”

Bëhet: “I licencuari do ta njoftojë ERE-n brenda 10 ditëve, për çdo ndryshim të:

- f) Adresës;
- g) Statutit të të licencuarit;
- h) Certifikatës së regjistrimit;
- i) NUIS;
- j) Drejtuesve të lartë; ose”

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 140 lekë